



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.41, datë 14.12.2022

PËR
RISHIKIMIN E KUSHTEVE TË LEJES SË NDËRTIMIT TË MIRATUAR ME
VENDIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT NR.21, DATË 14.10.2020,
PËR OBJEKTIN: “GODINË POLIFUNKSIONALE 1 DHE 6 KATE MBITOKË ME 1 KAT
NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË DURRËS


Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Kastrati Group” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rishikimit të kushteve të lejes së ndërtimit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 21, datë 14.10.2020, për objektin “Godinë Polifunksionale 1 dhe 6 kate mbitokë me 1 kat nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë “Kastrati Group” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.21, datë 14.10.2020, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

